



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 11.12.2019

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2018, PËR PROJEKTIN “MENAXHIMI I MODERNIZUAR I MBETJEVE DHE EKONOMIA RICIKLUESE NË RESPEKT TË MJEDISIT (DKTI)”

- HYRJJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 11 dhjetor 2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018, për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit (DKTI)”.

Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Z.Blendi Klosi, si dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 81, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenet 12 dhe 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018, për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit (DKTI)”.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin, me shpenzimet e saj, shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në një vlerë prej 4.500.000 eurosh.

Detajet e projektit si dhe detyrimet dhe shërbimet, që duhet të kryhen nga palët, do të përcaktohen në një kontratë të veçantë zbatimi që do të nënshkruhet ndërmjet GIZ-it, në cilësinë e agjencisë zbatuese të projektit, dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në cilësinë e institucionit përfitues të asistencës teknike.

- DISKUTIMI I PROJEKTLIGJIT NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit në Komision Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, z.Blendi Klosi, informoi deputetët lidhur me efektet që do të ketë zbatimi i marrëveshjes, sidomos në drejtim të përmirësimit të riciklimit të mbetjeve në disa bashki të nivelit të dytë.

Nga relatori dhe deputetët u kërkuar sqarime se në cilat bashki do të zbatohet projekti dhe nëse do të ketë kosto shtesë për këto bashki. Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se zbatimi i projektit do të përballohet me fondet e akorduara nga qeveria gjermane dhe detyrimi i vetëm i bashkive do të jetë përcaktimi i territorit ku do të kryhet riciklimi i mbetjeve.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

-Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e anëtarëve të pranishëm, dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORI

Edmond LEKA

KRYETARI

Ulsi MANJA